



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 635 Akti

**Nr. 611 Vendimi
Tiranë, më 9.1.2023**

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Firdes Shuli	Anëtare
Valbona Sanxhaktari	Relatore
Olsi Komici	Anëtar

asistuar gjatë procesit të vendimarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Jonida Vrana, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar znj. Marie Tuma, në datën 9.1.2023 mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Pajtime Fetah**, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b** i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; **Neni G** i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; **Ligji nr. 84/2016** “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; **Ligji nr. 96/2016**, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; **Ligji nr.44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; **Vendimi nr.78, datë 12.12.2017** i Gjykatës Kushtetuese.

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Subjekti i rivlerësimit, znj. Pajtime Fetah, gjatë periudhës së rivlerësimit kalimtar ka ushtruar detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Në zbatim të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës ky subjekt i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, “ex officio”.
2. Subjekti i rivlerësimit, znj. Pajtime Fetah, është shortuar në shortin e datës 15.12.2020 në përputhje me rregulloren e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni). Nga procedura e shortit rezultoi se procesi i rivlerësimit do të kryhet nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Firdes Shuli, Olsi Komici dhe Valbona Sanxhaktari e cila u zgjodh dhe relatore e çështjes sipas shortit.
3. Menjëherë pas hedhjes së shortit, bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, u administrua raporti i hartuar nga institucioni i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit

të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe grupi i punës në Këshillin e Lartë Gjyqësor (në vijim KLGj)

4. Trupi gjykues i shortuar pranë Komisionit, vendosi fillimin e hetimit administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, si dhe caktojë kryesues të trupit gjykues komisioneren Firdes Shuli, në vijim anëtarët deklaruan lidhur me konfliktin e interesit.

5. Komisioni, nëpërmjet postës elektronike njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi fillimin e procesit të rivlerësimit kalimtar, përbërjen e trupit gjykues dhe iu kërkua të shprehej nëse ishte në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e tij.

Subjekti i rivlerësimit me anë të postës elektronike në datë 29.1.2020, deklaroi se nuk është në kushtet e konfliktit të interesit me ndonjë nga anëtarët e trupit gjykues.

6. Komisioni, vijoi me hetimin administrativ për subjektin rivlerësues, në përfundim të të cilit, trupi gjykues, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, me vendimin e datës 24.10.2022 mbylli hetimin administrativ kryesisht, për subjektin e rivlerësimit Pajtime Fetah, për të tri kriteret e rivlerësimit dhe njoftoi atë për rezultatet e hetimit, barrën e provës dhe të drejtën për tu njohur me dokumentacionin e dosjes, kthimin e përgjigjeve dhe depozitimin e provave, brenda datës 7 nëntor 2022.

7. Në datën 7 nëntor subjekti i rivlerësimit ka informuar Komisionin, nëpërmjet komunikimit elektronik, se ajo ka paraqitur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, në datën 5 nëntor 2022, një kërkesë për dorëheqje të parevokueshme dhe përfundimin e statusit të magjistratit, duke vlerësuar të panevojshëm dorzimin e parashtrime mbi rezultatet e hetimit të dërguara nga Komisioni.

8. Në vijim të këtij komunikimi, Komisioni i ka kërkuar subjektin të rivlerësimit të vërë në dispozicion kërkesën drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor, me qëllim trajtimin e kërkesës së bërë prej saj nëpërmjet e-mail- it të datës 7 nëntor nga trupa gjykuese, sëbashku me dokumentacionin provues. Subjekti i rivlerësimit nuk i është përgjigjur këtij komunikimi të Komisionit.

9. Në datën 10 nëntor trupi gjykues është mbledhur dhe ka diskutuar mbi vijimësinë e procesit të rivlerësimit për subjektin Pajtime Fetah, ku në përfundim ka vlerësuar se nëpërmjet komunikimeve me e-mail nuk mund të vlerësojë qasjen e subjektit lidhur me vijimësinë e procesit të rivlerësimit. Ndërprerja e funksionit për shkak të daljes në pension nuk mund të barazohet me dorëheqjen, pasi janë dy koncepte krejtësisht të ndryshme, ndaj trupi gjykues ka çmuar si të nevojshme, thirrjen e subjektit të rivlerësimit në një seancë degjimore publike për të shprehur vullnetin e saj për vijimin e procedurës së rivlerësimit dhe nëse dëshiron të thotë dicka lidhur me këtë proces të iniciuar ndaj saj. Trupi gjykues ka vendosur që seanca degjimore të zhvillohet në datën 15 nëntor 2022 ora 10:00, në sallën e seancave degjimore, në Pallatin e Koncerteve.

10. Në datën 11 nëntor Komisioni ka (njoftuar) ftuar subjektin e rivlerësimit në seancë degjimore publike që ajo të paraqesë qëndrimin e saj lidhur me procesin e rivlerësimit. Në vijim të këtij njoftimi, në datën 11 nëntor, subjekti i rivlerësimit nëpërmjet komunikimit elektronik ka informuar Komisionin se i është drejtuar KLGJ me një kërkesë për daljen në pension pleqërie, duke bashkëlidhur kërkesën drejtuar këtij institucioni.

11. Në datën 12 nëntor nëpërmjet komunikimit elektronik, subjekti ka kërkuar shtyrjen e seancës degjimore, derisa KLGJ të shprehet në lidhje me kërkesën e saj.

12. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka informuar Komisionin se, pranë KLGJ në datën 9.11.2022 është depozituar një kërkesë nga zj. Pajtime Fetah, nëpërmjet të cilës ajo ka kërkuar mbarimin e statusit të magjistratit për shkak të moshës së detyruar për pension pleqërie. Kjo kërkesë është shqyrtuar nga Komisioni në datën 14 nëntor 2022.

13. Komisioni, pasi ka vlerësuar kërkesat e subjektit të rivlerësimit dhe dokumentacionin provues që dispononte lidhur me to, ka vendosur të vijojë shqyrtimin e çështjes në seancë

dëgjimore publike, pasi ndërprerja e funksionit për shkak të daljes në pension dhe dorëheqja janë dy koncepte krejtësisht të ndryshme. Për sa kohë që subjekti nuk ka mbushur moshën 67 vjeç sipas parashikimeve të ligjit nr.96/2016, dalja në pension pleqërie mbështetet në vullnetin/dëshirën e subjektit të rivlerësimit. Komisioni ka vlerësuar të rëndësishëm në kuadër të këtij procesi, shprehjen e vullnetit të subjektit për të vijuar ose jo procesin e rivlerësimit ndaj saj.

14. Në datën 15.11.2022 është zhvilluar seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit Pajtime Fetah, e cila nuk ishte prezent në seancë, por ka zgjedhur të përfaqësohet nga një përfaqësuese ligjore. Në përfundim të seancës dëgjimore përfaqësuesja e subjektit të rivlerësimit kërkoi shtyrjen e seancës dëgjimore, për t'i lënë mundësi Këshillit të Lartë Gjyqësor, të shqyrtojë kërkesën e subjektit për mbarim të statusit të magjistratit si edhe dorëheqjen e saj të parevokueshme.

15. Këshilli i Lartë Gjyqësor në datën 24.11.2022, ka vënë në dijeni Komisionin, për Vendimin nr.***, datë 21.11.2022, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për mbarimin e statusit të magjistratit për gjyqtare e Gjykatës, së Rrethit Gjyqësor Elbasan, Pajtime Fetah, për shkak të dorëheqjes së saj.” Efektet e këtij urdhërimi fillojnë më datë 31.12.2022.

16. Komisioni, pas njohjes me vendimin e KLGJ, ka komunikuar me anë të postës elektronike në datë 30.11.2022 me subjektin e rivlerësimit nëse dëshiron që të marrë pjesë në një seancë dëgjimore për të shprehur vullnetin e saj lidhur me përfundimin e procesit të rivlerësimit në zbatim të nenit G i Aneksit të Kushtetutës, pasi pas marrjes së vendimit nr.***/2022 të KLGJ subjekti i rivlerësimit nuk gëzonte më statusin e magjistratit dhe, për pasojë, nuk është më subjekt i ligjit nr. 84/2016.

17. Subjekti i rivlerësimit me anë të postës elektronike me datë 1.12.2022 ka njoftuar Komisionin se ajo nuk dëshiron të marrë pjesë në seancë dëgjimore publike dhe është dakort që të ndërpritet procesi i rivlerësimit në bazë të nenit G të Aneksit të Kushtetutës.

18. Komisioni është informuar nga KLGJ se subjekti rivlerësimit është njohur me vendimin nr.***/2022 të KLGJ në datën 25.11.2022 e se deri në datën 21.12.2022 nuk është paraqitur ankim ndaj këtij vendimi. Ky informacion është konfirmuar edhe nga Gjykata Administrative e Apelit. Zonja Pajtime Fetah gjithashtu ka informuar Komisionin nëpërmjet komunikimit elektronik se nuk ka ushtruar ankim ndaj Vendimit nr.***, datë 21.11.2022, të KLGJ.

II. ARSYET PËR PËRFUNDIMIN E PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

19. Procesi i rivlerësimit ndaj subjektit të rivlerësimit, znj. Pajtime Fetah ka filluar në respektim të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së R.SH dhe të pikës 4 të nenit 4 të ligjit 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.”

20. Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara më lart, konstaton se:

(i) Subjekti i rivlerësimit, Pajtime Fetah, ka ushtruar funksionin e gjyqtarës pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.

(ii) Subjekti i rivlerësimit, Pajtime Fetah, ka ushtruar të drejtën e daljes së parakohshme në pension pleqërie.

(iii) Subjekti i rivlerësimit, ka paraqitur kërkesën e saj pranë KLGJ-së dhe kjo e fundit me Vendimin nr.***, datë 21.11.2022, ka vendosur deklarin e mbarimit të statusit të magjistratit Pajtime Fetah, për shkak të dorëheqjes.

(iv) Vendimin nr.***, datë 21.11.2022 i KLGJ nuk është ankimuar.

21. Neni 65, i ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka parashikuar procedurën që duhet ndjekur për mbarimin e statusit të magjistratit¹.

¹ 1. Magjistrati mund të kërkojë mbarimin e statusit, nëpërmjet paraqitjes së dorëheqjes para Këshillit përkatës. 2. Dorëheqja duhet të jetë me shkrim dhe nuk është e nevojshme të jetë e arsyetuar. Dorëheqja jep efektet në fund të muajit pasardhës, nga dita kur Këshilli merr deklarinim me shkrim të dorëheqjes. Mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet me vendim të Këshillit jo më vonë se dy javë nga mbarimi i statusit.”

22. Neni “G”, i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ka parashikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit për të dhënë dorëheqjen, si vijon: *“1. Subjekti i rivlerësimit mund të japë dorëheqjen nga detyra dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet. 2. Subjekti i rivlerësimit që dorëhiqet sipas kësaj dispozite, nuk mund të emërohet gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare”*.

23. Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 43, ka interpretuar, ndër të tjera, lidhjen ndërmjet këtyre dy dispozitave, si vijon: *“[...] Neni 56 i ligjit i jep mundësinë subjektit që dorëhiqet brenda afatit 3-mujor, të përfitojë pagesë kalimtare sipas parashikimeve ligjore në fuqi, mundësi të cilën nuk e përfitojnë subjektet që e japin dorëheqjen pas përfundimit të këtij afati. Gjykata thekson se, për sa kohë që subjekti i rivlerësimit është në detyrë dhe procesi i rivlerësimit nuk ka përfunduar ende, ai ka të drejtën të japë dorëheqjen dhe në këtë rast procesi i rivlerësimit ndërpritet, duke u zbatuar parashikimet e nenit G të Aneksit të Kushtetutës [...]”*.

24. Për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor dhe respektimin e të drejtës së subjektit për t’u dëgjuar, bazuar në nenin 55, të ligjit 84/2016, Komisioni mban parasysht vullnetin e subjektit të rivlerësimit e cila nëpërmjet komunikimit elektronik shprehu vullnetin e saj për të mos marrë pjesë në seancën dëgjimore publike dhe deklaroi mosankimin e vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor për mbarimin e statusit të magjistratit.

25. Në këto kushte, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka shprehur vullnetin për të mos vazhduar ushtrimin e detyrës deri në mbushjen e moshës 67 vjeç, rast në të cilin, sipas përcaktimit ligjor, mbarimi i statusit të magjistratit deklarohet nga KLGj-ja. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, me vullnetin e saj, ka lënë detyrën që ushtronte përkundrejt mundësisë/parashikimit ligjor për të vazhduar ushtrimin e funksionit, pasi me veprime konkrete, ka hequr dorë nga ushtrimi i saj, ndërkohë që ende nuk kishte mbushur moshën 67 vjeç, të përcaktuar nga ligji nr. 96/2016, për të dalë në pension të plotë pleqërie dhe të vazhdonte të ushtronte detyrën e të gëzonte statusin e magjistratit edhe për disa vjet të tjerë, duke plotësuar në këtë mënyrë kushtet për të kualifikuar këtë situatë faktike sipas parashikimit të nenit G të Aneksit të Kushtetutës dhe si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit humbet të drejtën për t’u emëruar gjyqtar ose prokuror i çdo niveli, anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor ose i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektor i Lartë i Drejtësisë ose Prokuror i Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit “G”, të Aneksit të Kushtetutës².

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në nenin “G”, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 57, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenin 64, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, znj. Pajtime Fetah.

² Komisioni në aplikimin e parashikimeve të pikës 1 dhe 2 të nenit G të Aneksit të Kushtetutës mban parasysht edhe praktikën e konsoliduar tashmë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit referuar vendimeve nr.17/2021 (JR) datë 6.7.2021 për subjektin G.L dhe nr.36/2021 (JR) datë 24.11.2021 për subjektin A.G, etj.

2. Ndalimin e emërimit të znj. Pajtime Fetah si gjyqtare ose prokurore në çdo nivel, anëtare e Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Inspektore e Lartë e Drejtësisë ose Prokurore e Përgjithshëm, për një periudhë 15-vjeçare.

3. Ky vendim u njoftohet, subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall, në datën 9.1.2023

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Firdes Shuli

Kryesuese

Olsi Komici

Anëtar

Valbona Sanxhaktari

Relatore

Sekretare gjyqësore

Jonida Vrana